



Tiranë, më 12/03/2020.

Nr. 2 prot.

VENDIM

Nr. 2, Datë 12/03/2020

**PËR HAPJEN E PROCESIT TË APLIKIMEVE PËR ANËTAR TË KZF-ve NË
FAKULTETET E UNIVERSITETIT TË ARTEVE**

Në mbështetje të ligjit nr. 80/2015, datë 22.07.2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", të Ligjit nr. 8480, datë 27.05.1999 "Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike" urdhrin e Ministrit të Arsimit dhe Sportit Nr. 8, dt. 14.01.2020 dhe Rregulloren "Për organizimin e zgjedhjeve për autoritetet drejtuese dhe senatin akademik në Universitetin e Arteve", Komisioni Institucional i Zgjedhjeve në mbledhjen e datës 12.03.2020,

VENDOSI:

1. Hapjen e procedurave për zgjedhjen e anëtarëve të KZF-ve të fakulteteve të cilët vetëkandidohen duke dorëzuar aplikimin në sekretarinë e KIZ.
2. Procesi i pranimit të aplikimeve është nga data 12.03.2020 deri në datën 18.03.2020, pranë sekretarisë së KIZ nga ora 10.00-12.00
3. Ky vendim i përcillet Dekanëve të Fakulteteve.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

Suela AGOLLI